



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih Poslova/
Ministry of Internal Affairs
Inspektorati Policor i Kosovës



RAPORTI VJETOR 2017



INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS

RAPORTI VJETOR 2017





MISIONI I IPK-SË

MISIONI I INSPEKTORATIT POLICOR TË KOSOVËS ËSHTË QË PËRMES USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË SË TIJ, TË SIGUROJË NJË SHËRBIM POLICOR TË PËRGJEGJSHËM, DEMOKRATIK DHE TRANSPARENT, NË PËRPUTHJE ME LEGJISLACIONIN NË FUQI DHE STANDARDET E KËRKUARA.



FUSHËVEPRIMI I IPK-SË

OBJEKT I VEPRIMTARISË SË IPK-SË ËSHTË:

- 1. PARANDALIMI, ZBULIMI, DOKUMENTIMI DHE HETIMI I VEPRAVE PENALE TË KRYERA NGA PUNONJËSIT E POLICISË SË KOSOVËS, PA DALLIM GRADE DHE POZITE GJATË USHTRIMIT SË DETYRËS OSE JASHTË SAJ.**
- 2. INSPEKTIMI I STRUKTURAVE DHE FUNKSIONEVE TË POLICISË SË KOSOVËS PËR TË SIGURUAR LLOGARIDHËNIE, EFEKTIVITET DHE EFIKASITET NË ZBATUESHMËRINË E LIGJEVE, AKTEVE NËNLIGJORE DHE PROCEDURAVE STANDARDE TË OPERIMIT NË FUQI.**
- 3. HETIMI DHE/OSE INSPEKTIMI I INCIDENTEVE DISIPLINORE TË PROFILIT TË LARTË, KU PËRFSHIHEN TË GJITHË PUNONJËSIT E POLICISË SË KOSOVËS;**
- 4. HETIMI I TË GJITHA SHKELJEVE DISIPLINORE TË SUPOZUARA TË ZYRTARËVE POLICOR ME GRADËN MË TË LARTË TË NIVELIT TË LARTË TË MENAXHIMIT DHE ZYRTARËVE POLICOR TË NIVELIT TË LARTË EKZEKUTIV.**
- 5. KUR EKZISTON DYSHIMI I BAZUAR SE DREJTORI I PËRGJITHSHËM I POLICISË KA KRYER SHKELJE DISIPLINORE, KRYEMINISTRI MUND TË AUTORIZON IPK-NË PËR ZHVILLIM TË HETIMEVE DISIPLINORE. IPK-JA PAS PËRFUNDIMIT TË HETIMEVE DISIPLINORE I RAPORTON KRYEMINISTRIT PËR TË GJETURAT.**
- 6. PRANIMI I TË GJITHA ANKESAVE TË QYTETARËVE SI DHE SHQYRTIMI DHE PËRCAKTIMI SE CILAT NGA ANKESAT HETOHEN NGA IPK DHE CILAT DO T'I REFEROHEN POLICISË SË KOSOVËS APO INSTITUCIONEVE PËRGJEGJËSE.**

SHKURTESAT

AKSP	Akademia e Kosovës për Siguri Publike
AQP	Agjencia e Prokurimeve Qendrore
DCAF	Qendra e Gjenevës për Kontroll Demokratik të Forcave të Armatosura
DFSHP	Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme
DPP	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
DRP	Drejtoria Rajonale e Policisë
DRPK	Drejtoria Rajonale e Policisë Kufitare
DH	Departamenti i Hetimeve
DHKEK	Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit
DHS	Departamenti i Hetimeve Speciale
EULEX	Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
ICITAP	Internacional Criminal Investigative Training Assistance Program
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
KEEP	Kodi Evropiane i Etikës Policore
LPP	Ligji për Prokurimin Publik
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
NJHDPK	Njësia e Hetimeve të Drejtorisë së Policisë Kufitare
NJHR	Njësia e Hetimeve Rajonale
NJTR	Njësia e Trafikut Rajonal
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PK	Policia e Kosovës
PSO	Procedura Standarde e Operimit
SPK	Stacioni Policor Kufitar
SPMK	Stacioni Policor për Mbikëqyrjen e Kufirit
TI	Teknologjia Informativë
UE	Unioni Evropian

PËRMBAJTJA

- I. FJALA HYRËSE E KRYESHEFIT EKZEKUTIV**
- II. HYRJE**
- III. AKTIVITETET E IPK-SË NË MENAXHIMIN E ANKESAVE**
- IV. AKTIVITETET E IPK-SË NË HETIMET E RASTEVE**
- V. PERFORMANCA POLICORE E VLERËSUAR NGA INSPEKTIMET**
- VI. MBËSHTETJA EFUNKSIONEVE OPERATIVE TË IPK-së NGA DFSHP-ja**
- VII. MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN, BASHKËPUNIMI VENDOR E NDËRKOMBËTAR**

I. FJALA HYRËSE E KRYESHEFIT EKZEKUTIV

Të nderuar lexues,

Kam nderin të prezantoj rezultatet dhe të arriturat e punës së IPK-së për vitin që lamë pas. Edhe gjatë vitit 2017, në të gjitha nivelet organizative të IPK-së, është punuar në ngritjen e efikasitetit dhe efektivitetit, në përmbushjen e misionit dhe autorizimeve ligjore të zbatimit të ligjit, në funksion të mbikëqyrjes së punës së Policisë së Kosovës.



Angazhimi i gjithë strukturës së IPK-së në përmbushjen e detyrave përkatëse, ka ngritur në vazhdimësi përkrahjen dhe besimin e qytetarëve tek organizata jonë, si një kontribuuese e denjë drejt zhvillimit të një force policore demokratike, profesionale e të përgjegjshme, gjithmonë duke u përkujdesur në mbrojtjen dhe sigurimin e të drejtave të qytetarëve.

Rritja e profesionalizmit dhe nivelit të bashkëpunimit, me qytetarët dhe me partnerët, është shprehur përmes të dhënave të pasqyruar në këtë Raport. Së bashku me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë, IPK do të angazhohet tutje që ta ruaj dhe fuqizoj edhe më shumë këtë besim. Ruajtja e këtij besimi do të realizohet duke siguruar punë profesionale dhe cilësore, konfidencialitet gjatë trajtimit të informacioneve, nivel të lartë të integritetit, vlera morale të punonjësve, si dhe shtrirje të shërbimit sa më afër qytetarëve.

Gjatë gjithë periudhës së rrugëtimit në përmbushje të misionit ligjor, por edhe të zhvillimit si institucion, përfshirë ngritjen e kapaciteteve, realizimin e reformave të nevojshme organizative dhe të infrastrukturës ligjore, IPK është përkrahur në çdo hap nga institucionet vendore dhe partnerët ndërkombëtarë. Ministria e Punëve të Brendshme ka luajtur një rol të rëndësishëm në ofrimin e gjithë mbështetjes së nevojshme institucionale. Bashkëpunimi me Prokurorin e Shtetit mbetet i një rëndësie të veçantë drejt koordinimit e bashkërendimit të veprimeve të përcaktuar me ligjin në fuqi.

Roli i partnerëve tjerë vendorë e ndërkombëtarë ka qenë shumë i dukshëm në zhvillimin e vazhdueshëm të IPK-së. Përkrahja e tyre vetëm se ka ngritë cilësinë e angazhimeve tona, qoftë përmes programeve trajnuese, ofrimit të këshillave dhe përvojave, por edhe mbështetjes teknike.

IPK-ja vazhdon që të jetë e përkushtuar në avancimin e mëtejshëm profesional, përmes programeve trajnuese profesionale për punonjësit tanë, me qëllim të përqafimit të teknikave sa më të avancuara, si në fushën e hetimit penal, ashtu edhe në atë të inspektiveve, si një mekanizëm shumë i rëndësishëm parandalues.

Fuqizimi i kapaciteteve do t'i mundësojë IPK-së që të punojë edhe më shumë në parandalimin dhe luftimin e çdo dukurie negative brenda Policisë së Kosovës, sidomos të korrupsionit, duke ngritur në këtë mënyrë nivelin e përgjegjësisë dhe llogaridhënies në radhët e Policisë, si një ndër policitë më të mira në rajon.

Në fund, më lejoni t'iu rikujtoj se të dhënat e prezantuara në këtë raport, të arriturat dhe indikatorët e tjerë të suksesit, janë rezultat i përkushtimit të të gjithë punonjësve të IPK-së, të cilët i falënderoj duke iu siguruar mbështetjen time të vazhdueshme, drejt ngritjes së nivelit të zhvillimit institucional, profesional dhe fuqizimit të mirëqenies së tyre.

Hilmi Mehmeti
Kryeshef Ekzekutiv
Inspektorati Policor i Kosovës

II. HYRJE

Ky është Raporti përmbledhës i punës së Inspektoratit Policor të Kosovës (IPK) për periudhën janar – dhjetor 2017, i cili përmban aktivitete dhe të arritura të dokumentuara. Raporti i këtij viti prezanton sfidat dhe aktivitetet e ndërmarra, bazuar në kompetencat e parapara me legjislacionin në fuqi dhe të arriturat kryesore gjatë kësaj periudhe.

IPK-jasi agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) i ka zbatuar funksionet e saja përmes departamenteve operative siç janë: Departamenti për Menaxhimin e Ankesave, Departamenti i Hetimeve, Departamenti i Inspektimeve, Departamenti për Planifikim, Bashkëpunim, Çështje Ligjore e Informim, kurse Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme, përmes aktiviteteve të saj, ka mbështetur funksionimin e departamenteve operative në aspektin administrativ dhe logjistik.


Raporti i këtij viti paraqet edhe sfidat dhe të arriturat kryesore të IPK-së gjatë vitit 2017. Pjesët kryesore të këtij Raporti padyshim janë pjesët ku përmbledhen rezultatet konkrete në pranimin e ankesave dhe të hetimit të rasteve, sipas mandateve të IPK-së bazuar në numrin, kualitetin dhe rezultatet e hetimit të rasteve si dhe rezultatet konkrete në ushtrimin e funksionit të inspektimit, ku paraqiten numri, lloji dhe rezultatet e këtyre inspektimeve. Mbështetja administrative e cila ofrohet nga Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme na jep të dhëna lidhur me numrin e trajnimeve dhe nivelin e shpenzimeve buxhetore sipas kategorive ekonomike.

Pjesa e bashkëpunimit me qytetarët, organizatat vendore dhe ndërkombëtare përmban aktivitete konkrete të bashkëpunimit të IPK-së me të tjerët duke përfshirë, fushatat e ndryshme të informimit lidhur me të drejtat e qytetarëve, formën dhe mekanizmat e ankimit për të ngritur niveline vetëdijesimit sa i përket qasjes në IPK, ngritja e bashkëpunimit me organizatat e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare në profesionalizmin dhe ngritjen e cilësisë së performancës së punonjësve të saj përmes shkëmbimit të përvojave, trajnimeve, pranimit të këshillimeve dhe mekanizmave tjerë me interes për IPK-në.

III. AKTIVITETET E IPK-SË NË MENAXHIMIN E ANKESAVE

Departamenti për Menaxhimin e Ankesave (DMA) gjatë vitit 2017 ka pranuar gjithsej 1.226 ankesa, prej të cilave 21 kanë qenë informatave.

Diagrami 1. Trendi i ankesave të pranuar në DMA



Divizioni i Administrimit të Lëndëve si pjesë përbërëse e DMA-së, gjatë këtij viti ka pranuar dhe menaxhuar 1.226 ankesa. Të dhënat për numrin e ankesave dhe mënyrën e parashtrimit të tyre, janë të paraqitura në tabelën nr. 1 si në vijim:

Tabela 1: Paraqitja tabelore e numrit dhe mënyrës së arritjes së ankesave dhe informatave


Mënyrat e pranimit të ankesave	
Ankesat e pranuar në formë elektronike përmes postës elektronike	161
Ankesat e pranuar nga qytetarët në IPK	554
Ankesat e pranuar përmes PK-së	420
Ankesat e pranuar përmes kutive të ankesave	6
Ankesat e pranuar përmes mënyrave tjera në IPK (Prokuroria, Gjykata, etj)	16
Informatat e pranuar në IPK	21
Ankesat e pranuar përmes DH-IPK	42
Ankesat anonime	6
Gjithsej numri i ankesave dhe informatave të pranuar	1.226

Prijnë ankesat e pranuar drejtpërdrejt në IPK dhe ankesat e pranuar nga PK-ja.

Pasi që janë ndërmarr veprimet e nevojshme, hetuesit e Divizionit të Administrimit të Lëndëve kanë proceduar ankesat tek autoritetet përgjegjëse për hetim. Për hirë të transparencës, varësisht nga hapat që janë ndërmarrë për procedim të mëtejshëm të lëndës, hetuesi i administrimit të lëndëve ka njoftuar më pas parashtruesin e ankesës për statusin e ankesës.

Ankesat e trajtuara në IPK janë proceduar tek autoritetet kompetente dhe kjo shpërndarje është e paraqitur si në diagramin vijues:

Diagrami nr.2: Paraqitja tabelore mbi procedimin e ankesave nga DMA




Siç shihet nga diagrami mëlartë, 59 % e ankesave (rasteve) janë proceduar në Drejtorinë e Standardeve Profesionale të PK-së (DSP), si autoritet kompetent për trajtimin e shkeljeve disiplinore, kurse 40.5% e ankesave janë proceduar për hetim në Departamentin e Hetimeve të IPK-së (DH), si autoritet kompetent i IPK-së, kurse pjesa tjetër e mbetur janë mbyllur në IPK pas shqyrtimit nga DMA-ja, pasi që nuk kanë pasur elemente të shkeljeve disiplinore apo të veprave penale.

Bazuar në të dhënat e saj, DMA-ja ka evidentuar gjithsej 1.038 ankues që kanë parashtruar ankesat e tyre përmes mënyrave të autorizuara ligjore. Në këtë shifër nuk përfshihen parashtruesit e ankesave, të cilësuar si inicime të brendshme apo informatat e pranuar, që në total arrijnë shifrën në 188 sosh.

Sa i përket klasifikimit të ankesave të pranuar në bazë të gjinisë, kemi këto të dhëna: nga ankuesit e gjinisë mashkullore janë pranuar 902 ankesa, ndërsa nga ata të gjinisë femërore janë pranuar 136 të tilla.


Sa i përket klasifikimit të ankesave të pranuar në bazë të përkatësisë etnike, nga diagrami i mëposhtëm shihet se 92% e ankuesve janë nga komuniteti shumicë, derisa pjesa tjetër prej 8% janë nga komunitetet pakicë.

Diagrami nr.3: Paraqitja tabelore e ankesave sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike të ankuesve



IPK-ja ka nxjerrë edhe ngarkesën për muaj, lidhur me numrin e ankesave, ku muajt më të ngarkuar kanë qenë gushti dhe shtatori, kurse muajt me më pak ankesa të parashtruara në IPK, kanë qenë janari dhe dhjetori.

Diagrami nr.4: Paraqitja tabelore e ankesave të pranura përgjatë muajve



Është bërë edhe analizimi i ankesave të paraqitura në bazë të drejtorive regjionale policore ku punojnë zyrtarët policorë. Nga kjo kanë dalë të dhënat si në vijim:

1. Regjioni i Prishtinës prinë me 484 ankesa;
2. Regjioni i Prizrenit përfaqësohet me 91 ankesa;
3. Regjioni i Gjilanit përfaqësohet me 110 ankesa;
4. Regjioni i Mitrovicës Jug përfaqësohet me 76 ankesa;
5. Regjioni i Pejës përfaqësohet me 122 ankesa;
6. Regjioni i Ferizajt përfaqësohet me 109 ankesa;
7. Regjioni i Mitrovicës Veri përfaqësohet me 57 ankesa;
8. Regjioni i Gjakovës përfaqësohet me 50 ankesa, dhe
9. Pikat kufitare përfaqësohen me 40 ankesa.

Kemi një numër të konsiderueshëm të ankesave ku nuk dihet se ku punon zyrtari policor i dyshuar ndaj të cilit është ushtruar ankesë, e numri i tyre arrijnë në 87 ankesa.

Pesë (5) ankesat më të shpeshta të qytetarëve që janë klasifikuar me **elemente penale** sipas emërimit të veprës penale janë:

1. Keqpërdorim i detyrës apo autoritetit zyrtar.....107
2. Lëndim trupor..... 60
3. Manipulim me prova materiale.....55
4. Aksident trafiku me lëndime..... 54
5. Keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare.....45


Pesë (5) ankesat më të shpeshta të qytetarëve, të klasifikuara me **elemente të shkeljes së disiplinës**/DSP, të emëtuara si shkelje disiplinës janë:

1. Sjellje e pahijshme.....307
2. Tiketë..... 154
3. Neglizhencë.....98
4. Mos paraqitje e gjendjes reale në raporte të aksidenti.t.....24
5. Përdorimi i forcës dhe dënime selektive20


IV. AKTIVITETET E IPK-SË NË HETIMIN E RASTEVE

Gjatë periudhës së raportimit, Policia e Kosovës ka pasur 8.750 punonjës. Në total ishin 190 punonjës të PK-së si subjekt i hetimit nga IPK-ja. Të paraqitur në përqindje, llogaritet që 2.2% e punonjësve të PK-së ishin nën hetim nën dyshim se kanë kryer vepra penale. Kjo përqindje është 0.51% më pakse vitin e kaluar. Pra, në vitin 2017 numri i punonjësve të hetuar është më i vogël për 51 punonjës në krahasim me vitin 2016.

Diagrami 5




Diagrami 6



Sipas evidencave të IPK-së, 496 ankesa janë dërguar në Departamentin e Hetimeve për hetime preliminare dhe 135 janë bartur nga viti 2016 (gjithsej 631). Gjatë hetimit preliminar të këtyre ankesave, 166 ankesa (26.3 %) kanë rezultuar me elemente të veprës penale dhe kanë marrë numër rasti për t'u hetuar tutje, ndërsa 326 (51.6 %) të rasteve kanë rezultuar me elemente të shkeljes disiplinore dhe janë kthyer në DMA për t'i përcjellë në Drejtorinë e Standardeve Profesionale për hetime disiplinore. Sipas të dhënave tona, 133 raste (21.1 %) janë ende në hetim preliminar, raste këto që kryesisht janë pranuar në dy muajt e fundit të vitit 2017 dhe gjashtë (6) raste tjera (1 %) janë raste të cilat janë proceduar në institucionet tjera përkatëse.

Numri përgjithshëm i rasteve të trajtuara për vitin 2017 është 496 raste dhe 135 raste të bartura nga viti 2016 (gjithsej 631 raste të trajtuar këtë vit). Sa i përket shkeljeve disiplinore të prezantuara si më poshtë në këtë diagram, 234 janë dërguar në kompetencë të DSP-së këtë vit, kurse 92 sosh janë të bartura nga viti 2016.

Diagrami 7.Paraqitja tabelore e lëndëve të trajtuara nga DH-ja.



Nga Departamenti i Hetimeve, prej 166 rasteve me elemente të veprës penale:

- a) 150 prej tyre (90.4%) janë dërguar në prokuroritë kompetente,
- b) 16 raste (9.6 %) janë në proces të hetimit¹, të bartura në vitin 2018.

Nga 150 raste sa janë dërguar në Prokurori:

- a) 110 raste (73.3 %) prej tyre janë dërguar me kallëzim penal²,
- b) Me raport të veçantë³ janë dërguar 40 raste (26.7 %).

IPK-ja ka arritur që 90.4% të rasteve me elemente kriminale t'i hetoj dhe procedoj tutje në Prokurori me kallëzim penal ose me raport të veçantë.


Gjatë vitit 2017, prej 110 rasteve që janë dërguar në prokuroritë kompetente me kallëzim penal, janë ngritur 57 aktakuza, kurse gjashtë (6) kallëzime penale janë hedhur poshtë nga prokuroritë përkatëse.

¹Raste të cilat janë akoma në hetim penal, por nuk janë dorëzuar në prokurorinë e shtetit.


² IPK-ja përpilon kallëzim penal në të cilin paraqiten provat e zbuluara në procesin e mbledhjes së të dhënave dhe i dorëzohet prokurorit të shtetit së bashku me sendet, skicat, fotografitë, raportet e marra, procesverbalet e masave dhe veprimeve të kryera, shënimet zyrtare, deklaratimet e marra dhe materialet e tjera të cilat mund të kontribuojnë në zbatimin efektiv të procedurës.

³Nëse masat dhe veprimet e kryera nga Inspektorati Policor i Kosovës, provat dhe të dhënat e mbledhura nuk sigurojnë bazë për kallëzim penal dhe nëse kjo nuk justifikon ekzistimin e dyshimit të arsyeshëm se është kryer veprë penale, Inspektorati Policor i Kosovës dërgon për këtë raport të veçantë në prokurori.


Diagrami 8



Diagrami 9




Diagrami 10: Statusi i rasteve të proceduara në prokurori me kallëzim penal (2015-2017)



Gjatë vitit 2017, IPK-ja ka ndërmarrë këto masa dhe rekomandime: 17 persona të arrestuar, prej të cilëve 12 zyrtarë policorë dhe 5 qytetarë, 30 rekomandime për suspendime dhe 7 rekomandime për transferim.

Diagrami nr. 11: Masat dhe rekomandimet nga IPK-ja (2015- 2017)




Gjatë vitit 2017, IPK-ja ka hetuar raste të llojeve dhe natyrave të ndryshme. Pesë (5) rastet më të shpeshta, bazuar në kallëzimet penale, që u hetuan gjatë vitit 2017 paraqiten në diagramin si në vazhdim:

Diagrami nr. 12. Pesë veprat më të shpeshta nën hetim nga IPK-ja për vitin 2017




Gjatë triviteve të kaluara (2015-2017), pothuajse të njëjtat vepra prijnë në listën e pesë (5) veprave më të shpeshta në kompetencë të IPK-së për hetim. Pozitive shihet trendi i rënies së rasteve ku përfshihen veprat e përdorimit të forcës nga zyrtarët policorë siç janë “Lëndimi i lehtë trupor” apo ‘Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare’, për të cilën IPK konsideron se ka ardhur si rezultat i inspektiveve të shpeshta të ndërmarra nga IPK-ja, hetimeve cilësore në këtë fushë dhe nga përkushtimi i menaxhmentit policor për të ofruar trajnime shtesë lidhur me këtë fushë të detyrave policore.

Diagrami nr. 13: Trendi i pesë veprave më të shpeshta nën hetim nga IPK-ja (2015- 2017)




IPK-ja edhe gjatë këtij viti, kujdes të veçantë i ka kushtuar veprave me elemente të “Korrupsionit zyrtar” dhe veprave penale “Kundër detyrës zyrtare”. Këtë vit, IPK-ja ka hetuar 36 raste me ‘Vepra penale kundër detyrës zyrtare’, ndër të cilat më të shpeshtat kanë qenë: 32 vepra të “Keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar”, gjashtë (6) vepra të “Marrjes së ryshfetit”, tre (3) vepra të “Ushtrimit të ndikimit”, dy (2) vepra të “Zbulimit të fshehtësisë zyrtare” dhe një (1) vepër të “Përvetësimit në detyrë”.

Diagrami nr. 14: Trendi i veprave penale me elemente të korrupsionit zyrtar dhe kundër detyrës zyrtare (2015- 2017)




Në diagramin e mëposhtëm është pasqyruar numri i të hetuarve, të ndarë sipas gradave, në raport me numrin aktual të burimeve njerëzore. Nga totali i punonjësve të PK-së prej 8.750 sosh, 7.677 janë zyrtarë policorë me grada të ndryshme, ndërsa 1.073 shërbyes civil pa kompetenca policore.

Diagrami 15: Diagrami i raportit në mes të numrit të punonjësve policorë sipas strukturës organizative dhe numrit të të hetuarve nga IPK-ja (sipas gradave)



Gjatë vitit 2017, IPK-ja ka hetuar 33 zyrtarë të graduar, prej tyre 1 nënkolonel, 3 kapiten, 10 togerë, 19 rreshterë, 148 zyrtarë policorë dhe 9 punonjës nga stafi civil.


Diagrami nr. 16: Gradate punonjësve të PK-së të hetuar nga IPK-ja (2015- 2017)



Bazuar në strukturën e saj organizative, PK përbëhet nga pesë (5) departamente. Numrin më të madh të punonjësve e ka Departamenti për Operacione me 6.235 punonjës apo 71.3% të tërë personelit të PK-së, Policia Kufitare me 1.322 punonjës apo 15.1 %, Departamenti për Hetime me 598 apo 6.8%, Departamenti për Shërbime Mbështetëse me 271 punonjës apo 3.1% dhe Departamenti i Burimeve Njerëzore me 134 punonjës ose 1.5 % e personelit në Policinë e Kosovës.

Numri më i madh i të hetuarve nga IPK-ja janë punonjës të Departamentit për Operacione, që përfaqësohet me gjithsej 149 punonjës, Departamenti për Kufi përfaqësohet me 28 punonjës, Departamenti për Hetime përfaqësohet me nëntë (9) punonjës, Departamenti për Shërbime Mbështetëse me tre (3) punonjës dhe Departamenti për Burime Njerëzore me një (1) punonjës.


Diagrami nr. 17: Paraqitja tabelore e shpërndarjes së 190 punonjësve të PK-së të hetuar nga IPK-ja (sipas departamenteve policore)



Duke u nisur nga fakti se Departamenti për Operacione ka numrin më të madh të punonjësve të angazhuar dhe numrin më të madh të të hetuarve nga IPK-ja, në vazhdim të Raportit është shtresuar sipas nën-ndarjeve tjera brenda këtij Departamenti, në cilat gjenden gjithsej 149 punonjës të hetuar nga IPK-ja.


Departamenti për Operacione ndahet në tre (3) divizione: Divizioni për Siguri Publike është prekur me 123 zyrtarë të hetuar nga IPK-ja, Divizioni i Njësive të Specializuara me 24 zyrtarë të hetuar dhe Divizioni i Komunikacionit Rrugor me dy (2) zyrtarë të hetuar nga IPK-ja. Në Divizionin për Siguri Publike dhe Divizionin e Komunikacionit Rrugor ka ulje të numrit të të hetuarve këtë vit, krahasuar me vitin paraprak, ndërsa në Divizionin e Njësive të Specializuara ka ngritje të numrit të të hetuarve krahasuar me dy vitet e fundit.

Diagrami nr. 18: Shpërndarja e punonjësve të hetuar brenda Departamentit për Operacione



Në diagramin më poshtë paraqitet trendi i numrit të punonjësve që ishin subjekt i hetimeve nga IPK sipas Drejtorive Rajonale Policore për tre vitet e fundit (2015-2017).


Diagrami nr. 19: Shpërndarja e punonjësve të hetuar sipas Drejtorive Rajonale Policore



Gjatë vitit 2015, Divizionit për Siguri Publike i është shtuar edhe Drejtoria Rajonale e Policisë në Gjakovë. Pjesa e përgjegjësisë së këtij rajoni, më parë ishte nën mbikëqyrjen e Drejtorisë Rajonale të Policisë në Pejë. Sa i përket numrit të punonjësve në Drejtoritë Rajonale të Policisë së Prizrenit, Ferizajt, Gjilanit, Pejës dhe Gjakovës ka rritje të numrit të hetuarve nga IPK-ja, ndërsa në Drejtoritë Rajonale të Policisë të Prishtinës, Mitrovicës së Veriut dhe Mitrovicës së Jugut kanë shënuar ulje të numrit të zyrtarëve policorë të hetuar.


Në diagram paraqitet numri i rasteve sipas stacioneve policore të cilat janë nën komandën e DRP-ve në kuadër të Divizionit për Siguri Publike (Departamentit për Operacione). Stacioni Policor i Ferizajt kryeson me numrin më të madh të punonjësve të hetuar nga IPK me gjithsej nëntë (9) punonjës ndaj të cilëve janë zhvilluar hetime penale, më pas vijnë Stacioni Policor i Novo-Bërdës dhe ai i Pejës me nga shtatë (7) zyrtarë policorë të hetuar. Pjesëmarrja e stacioneve tjera është e paraqitur në diagramin si në vijim.

Diagrami nr. 20: Punonjësit e PK-së të hetuar nga IPK-ja sipas stacioneve policore




Në diagramin 21 shihet shpërndarja e 28 punonjësve të Policisë Kufitare të hetuar nga IPK-ja, sipas Drejtorive Rajonale të Policisë Kufitare (DRPK). DRPK 'Perëndimi' kryeson me dhjetë (10) zyrtarëqë ishin subjekt të hetimeve penale nga IPK ja, pason DRPK 'Veriu' dhe DRPK 'Lindje' me nga shtatë (7) zyrtarë dhe Stacioni Policor 'Aeroporti' me katër (4) zyrtarë të hetuar.

Diagrami 21: Punonjësit e PK-së të hetuar nga IPK sipas Drejtorive Rajonale Policore Kufitare



Në diagramin e radhës paraqitet numri i punonjësve të PK-së të hetuar nga IPK-ja, sipas Stacioneve Policore Kufitare, të cilat janë nën komandën e DRPK-ve. Sipas të dhënave prinë SPK 'Kulla' me katër (4) zyrtarë, më pas vjen SPMK 'Vërmicë' me tre (3) zyrtarë, kurse me nga dy zyrtarë të hetuar janë SPMK 'Leposaviq', SPMK 'Kërpimeh', SPK 'Bërnjak' dhe SPK 'Dheu i bardhë', ndërsa me nga një (1) zyrtar të hetuar renditen SPMK 'Muqivërcë', SPMK 'Zhegër', SPMK 'Hani i Elezit', SPMK 'Gjakovë', SPMK 'Vitimiricë', SPK 'Muqibabë' dhe SPK 'Jarinjë'.


Diagrami nr. 22: Punonjësit e PK-së të hetuar nga IPK-ja sipas SPK-ve dhe SPMK-ve



V. INSPEKTIMET GJATË VITIT 2017

Një ndër funksionet bazë të IPK-së është edhe zhvillimi i inspektimeve ndaj Policisë së Kosovës. Përmes procesit të inspektimit, IPK-ja bënë vlerësimin e mënyrës së kryerjes së detyrave në PK duke:

- Përcaktuar nëse ligjet, rregulloret përkatëse dhe parimet e procedurat e PK-së, zbatohen ashtu si duhet dhe janë të përshtatshme për të arritur qëllimet e saj;
- Përcaktuar nëse burimet e Policisë, shfrytëzohen në mënyrë efektive dhe efikase si dhe janë të përshtatshme për të arritur qëllimet dhe objektivat organizative;
- Parandaluar shkeljet që mund të kryhen gjatë veprimtarisë së PK-së;
- Identifikuar mangësitë dhe duke rekomanduar masa ligjore dhe organizative për funksionim më të mirë të PK-së.



IPK në përmbushje të mandatit të tij ligjor, për të vlerësuar kryerjen e detyrave policore në raport me legjislacionin në fuqi dhe standardet e kërkuara, gjatë vitit që lamë pas, ka realizuar tetë (8) inspektime, gjashtë (6) prej të cilave të rregullta, në bazë të Planit Vjetor të Inspektimeve të Rregullta për vitin 2017 dhe dy (2) të jashtëzakonshme. Nëse u referohemi përmbushjes së objektivave vjetore, vlerësohet se janë përmbushur të gjitha planifikimet e synuara.

Brenda tremujorit të parë të vitit 2017, është nxjerrë Plani Vjetor i Inspektimeve të Rregullta, i cili është miratuar nga Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së.

Nxjerrja e këtij Plani ka kaluar në disa faza, duke marrë parasysh shumë faktorë dhe rrethana. Plani i tillë ka vënë para vetes disa objektiva të inspektimit, që kanë rezultuar nga objektivat strategjike të organizatës. Para çdo inspektimi është nxjerrë edhe nga një program pune, me të cilin janë detajuar veprimet operacionale në terren të ekipeve që kanë zbatuar detyrën inspektuese. Në përfundim të proceseve inspektuese, janë nxjerrë raporte me analiza dhe vlerësime mbi arritjen e objektivave inspektuese.

Gjatë vitit 2017 janë realizuar këto inspektime:

1. Menaxhimi i flotës së automjeteve policore dhe pajisjeve përcjellëse (i rregullt);
2. Menaxhimi i patrullimeve në trafik dhe sigurisë në rrugë (i rregullt);
3. Menaxhimi i prokurimit në Policinë e Kosovës (i rregullt);
4. Menaxhimi i hetimit dhe zbulimit të krimit, si dhe administrimit të rasteve (i rregullt);
5. Menaxhimi i ruajtjes dhe kontrollit të kufirit, si dhe migracionit (i rregullt);
6. Menaxhimi i ndërtesave policore, infrastrukturës dhe aseteve përcjellëse (i rregullt);
7. Vlerësimi i efikasitetit të shërbimeve të përbashkëta të policimit rrugor të Policisë së Kosovës dhe Policisë së Shtetit Shqiptar (i jashtëzakonshëm);
8. Përdorimi i automjeteve policore jashtë orarit zyrtar të punës (i jashtëzakonshëm).

Gjetjet kryesore të inspektimeve të realizuara gjatë vitit 2017

Inspektimi i menaxhimit të flotës së automjeteve policore dhe pajisjeve përcjellëse

Ky inspektim ka mbuluar periudhën dy (2) vjeçare 2015 dhe 2016. Gjetjet japin një pasqyrë se flota e automjeteve është e vjetërsuar me një kontingjent automjeteve pasive për shkak të jo funksionalitetit. Inspektimi ka shtruar nevojën e ngritjes së kujdesit në mirëmbajtjen e tyre, por edhe përdorimit nga drejtuesit e tyre. Janë evidentuar ngecje në realizimin e Planit të zëvendësimit të automjeteve. Nevojitet shtytje për procesin e tjetërsimit të automjeteve të papërdorshme dhe lirimin nga automjetet jo funksionale.



Vërehen lëvizje pozitive në kontrollin e automjeteve policore para përdorimit të tyre dhe të zvogëlimit të rasteve të dërgimit të tyre tek operatorët. Indikatorët e performancës tregojnë rritje produktiviteti dhe efikasiteti të shërbimeve të mirëmbajtjes së automjeteve, në raport me vitet e fundit edhe përkundër që Parku i Automjeteve është vjetërsuar.

Është vlerësuar e papranueshme performanca në fushën e përfshirjes së automjeteve zyrtare në aksidente trafiku dhe kjo konsiderohet performanca më negative e viteve të fundit. Kërkon trajtim serioz tendenca e mos raportimit me kohë, të aksidenteve dhe incidenteve me përfshirje policore, në Zyrën e Aksidenteve. Ka përparim në drejtim të pajisjes së automjeteve me një sërë pajisjesh përcjellëse e dokumentesh operacionale.

IPK-ja ka verifikuar edhe përmbushjen e rekomandimeve të lëna në inspektimet e fundit dhe ka konstatuar se nga 11 rekomandime të lëna në dy (2) inspektimet e kaluara, një (1) prej tyre është realizuar plotësisht, tre (3) janë përmbushur në masën më të madhe (përgjithësisht), një (1) është realizuar pjesërisht dhe gjashtë (6) nuk janë përmbushur. Në Raportin përfundimtar të inspektimit të kësaj fushe, janë vënë 12 rekomandime, të cilat nga drejtuesit e strukturës policore janë pranuar si të bazuara dhe të qëndrueshme.

Inspektimi i menaxhimit të patrullimeve në trafik dhe sigurisë në rrugë

Inspektimi ka mbuluar periudhën dy (2) vjeçare 2015 dhe 2016 dhe sa i përket kapaciteteve të burimeve njerëzore në mbulimin e zonave të përgjegjësisë, gjetjet japin një pasqyrë në stacione vërehen vështirësi në krijimin e ekipeve patrulluese me përbërje të plotë për 24 orë. Vërehen mangësi në përfshirjen e duhur të informatave në radiologë, që më tepër kanë të bëjnë me mos prezantim të të dhënave detale mbi aktivitetet policore.

Policia ka nxjerrë Planin Zhvillimor Strategjik dhe plane tjera vjetore që orientojnë aktivitete në ngritjen e gjendjes në komunikacion, duke vendosur prioritete bazuar në Strategjinë Kombëtare për Siguri Rrugore.

Pikë me rëndësi në krijimin e kushteve për punë cilësore e efikase të Policisë mbetet përmbushja e nevojave me pajisje teknike që krijojnë cilësi të shërbimit në ngritjen e sigurisë në trafik, të njohura si pajisje teknike të zbatimit të masave ligjore. Nevojitet përkushtim për qasje më aktive në trajtimin e pikave të zeza, drejt përmbjlljes së procesit të identifikimit të tyre, si faktorët e rrezikimit të sigurisë rrugore.



Vlerësohet pozitivisht shtimi i masave pro-aktive policore të sigurisë në rrugë për krijim të kushteve të sigurisë rrugore. Në nivel stacionesh dhe të njësive rajonale të komunikacionit rrugor, vërehet gjendje jo e mirë e pajisjes së ekipeve patrulluese me mjete pune, siç janë pajisjet për matjen e shpejtësisë së lëvizjes dhe pajisjet për matjen e prezencës së alkoolit tek personat e dehur.

Nga inspektimi i kryer ka rezultuar se nga gjashtë (6) rekomandime të lëna në inspektimin e kaluar, dy (2) prej tyre janë realizuar plotësisht, dy (2) janë në proces të realizimit dhe dy (2) janë realizuar pjesërisht.

Në raportin përfundimtar të inspektimit të kësaj fushe janë vënë gjashtë (6) rekomandime, të cilat nga drejtuesit e strukturës policore janë pranuar si bazuara dhe të qëndrueshme. Është arritur pajtueshmëri për përmbushjen e këtyre rekomandimeve sipas Planit të Veprimit të përcaktuar.

Inspektimi i vlerësimit të efikasitetit të shërbimeve të përbashkëta të policimit rrugor të Policisë së Kosovës dhe Policisë së Shtetit Shqiptar në territorin e Shqipërisë

Ky inspektim ka mbuluar performancën e dy policive rrugore gjatë sezonit veror. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës (DPP) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (DPPSH) kanë ndërmarrë veprimet konkrete të nevojshme përgatitore lidhur me zbatimin e Memorandumit të Bashkëpunimit në mes të të dyja vendeve.

Palët nënshkruese kanë hartuar urdhra operativ, që përcaktojnë objektivat dhe veprimet konkrete operative të strukturave policore të të dyja vendeve, drejt realizimit dhe zbatimit të Memorandumit.

Nga data 01.07.2017, për periudhën dy (2) mujore, nga PK-ja janë angazhuar gjashtë (6) ekipe patrulluese, të cilat kanë asistuar në ekipet e përbashkëta patrulluese me ato shqiptare. Ekipet e përbashkëta patrulluese të të dyja policive kanë aplikuar kontrolle dhe vëzhgim të mbarëvajtjes së qarkullimit rrugor, duke qëndruar nëpër pika statike dhe në vende të identifikuar si 'njolla të zeza'. Gjatë sezonit veror ka pasur shtim të theksuar të aktivitetit policor dhe ngritje të performancës policore në akset rrugore ku janë zhvilluar shërbime të patrullimit të përbashkët.



Indikatorët e performancës tregojnë se, gjatë vitit 2017, ka pasur shtim të numrit të patrullimeve të përbashkëta policore, shtim të pikave të kontrollit dhe shtim të numrit të gjobave të shqiptuara për kundërvajtje në trafik. Krahasuar me vitin e kaluar, gjatë këtij sezoni veror është shënuar rënie e numrit të aksidenteve të trafikut të shkaktuara brenda zonave ku janë zhvilluar shërbime të përbashkëta patrullimi. Brenda kësaj zone të përgjegjesisë, nuk janë shënuar aksidenteme pasoja të rënda, ka pasur rënie të numrit të aksidenteve me pasoja/lëndime të rënda trupore dhe rënie të numrit të aksidenteve me pasoja/ lëndime lehta trupore.

Indikatorët e sigurisë rrugore tregojnë se në këtë sezon, ka pasur një ngritje të lehtë të numrit të aksidenteve rrugore me dëme materiale, në krahasim me sezonin e njëjtë të vitit të kaluar. Inspektimi ka vënë në pah se patrullat policore ishin të pajisur me automjete, uniforma zyrtare brenda standardit dhe pajisje tjera personale.

Është vërejtur mungesë e pajisjeve teknike për matjen e shpejtësisë së lëvizjes së mjeteve motorike dhe pajisjeve radio-komunikuese. Pajisjet për matjen e shpejtësisë së lëvizjes së mjeteve motorike që janë pronë e PK-së, nuk kanë mundur të përdoren në patrullimet e përbashkëta brenda territorit shqiptar, për arsye se nuk janë të kalibruara nga institucioni kompetent i Republikës së Shqipërisë. Duhet cekur edhe mangësinë e mos kompletimit të të gjitha patrullave policore me pajisje policore për trajtimin e aksidenteve në komunikacion. E dukshme është mungesa e foto kamerave, reflektorëve për ndriçim të vendit të aksidentit dhe metrit matës.

Qytetarët e intervistuar nga ekipi i IPK-së dhe Shërbimit për Çështje të Brendshme dhe Ankesa, kanë shprehur opinion pozitiv lidhur me organizimin e patrullimit të përbashkët të të dyja policive dhe e kanë mirëpritur një veprim të tillë. Ata janë shprehur të kënaqur dhe përkrahin prezencën e këtyre njësive policore, për bashkëpunim në policimin rrugor, drejt ngritjes së sigurisë rrugore. Numër i konsideruar i tyre, janë deklaruar se nuk kanë njohuri të mjaftueshme për organizimin e patrullimeve të përbashkëta, derisa gjendjen e sigurisë përgjatë akseve rrugore e konsiderojnë të mirë.

Askush nga qytetarët e kontaktuar nuk ka shprehur ankesë sa i përket sjelljeve të policëve patrullues nëpër këto akse, por kishte të atillë që nuk kishin njohuri të mjaftueshme mbi atë se në cilat instanca mund të drejtohen nëse, konsiderojnë se në ndonjë situatë të caktuar, atyre mund t'u shkelen të drejtat.

Nga inspektimi i kryer rezultoi se nga pesë (5) rekomandime të lëna nga inspektimi i kaluar, janë përmbushur dy (2) rekomandime dhe tre (3) të tjera nuk janë përmbushur fare. Në raportin përfundimtar të inspektimit të kësaj fushe, janë vënë gjashtë (6) rekomandime, të cilat nga drejtuesit e dy strukturave policore janë pranuar si të bazuara dhe të qëndrueshme. Është arritur pajtueshmëri për përmbushjen e rekomandimeve sipas Planit të Veprimit të përcaktuar.

Inspektimi i menaxhimit të prokurimit në Policinë e Kosovës

Ky inspektim ka mbuluar aktivitetet e Autoritetit Kontraktues për periudhën dy (2) vjeçare 2015 dhe 2016. Gjetjet japin një pasqyrë se Drejtoria e Prokurimit ka kapacitetet e nevojshme njerëzore dhe profesionale për të përmbushur nevojat dhe kërkesat si dhe për të ushtruar aktivitetet prokuruese përbrenda kompetencave të përcaktuara me Ligjin për Prokurimin Publik (LPP). Personeli i angazhuar në Drejtori vlerësohet se ka kapacitetet e mjaftueshme profesionale ngase është i përkrahur nga programet adekuate trajnuese, por edhe certifikuese.



Inspektimi ka vënë në pah një bashkëpunim dhe koordinim të mirë në mes të disa akterëve të përfshirë apo të ndërlidhur me funksionet prokuruese. Drejtoria ka kryer dhe ka nxjerr me kohë Planifikimin e Prokurimit, por që ka reflektuar me nevojën që në të ardhmen, të jetë më gjithëpërfshirës, më i qëndrueshëm dhe më përmbajtësor. Drejtoria ka përmbushë raportimin vjetor në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik.

Është identifikuar avancim në mbajtjen e dosjeve të prokurimit, qoftë si përmbajtje apo si vendosje dhe sistemim në hapësira adekuate. Dosjet në formën e një Regjistri Përmbledhës janë më të plota dhe më të kompletuara. Shihen lëvizje pozitive në përgatitjen me kohë të dosjeve të tenderit, vendosjen e afateve kohore për dorëzimin e tenderëve si dhe përgatitjen e specifikimeve teknike dhe termave referues. Shihet mobilizim në drejtim të eliminimit të disa dukurive që kanë qenë në kundërshtim me legjislacionin aktual, siç ishin: plotësimi i dosjeve tenderuese nga persona të njëjtë, nënshkrimi i kontratave pasi që furnizimet ishin kryer dhe konkurrenca e kufizuar.

Publikimi i njoftimeve të kontratave është bërë në të gjitha rastet e ekzaminuara, ka lëvizje pozitive edhe sa i përket fillimit dhe përfundimit të periudhës së ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve brenda afateve kohore. Po ashtu, nuk është hasur në kontrata të nënshkruara para kohe.

Duhet punuar në nxjerrjen e planeve më të qëndrueshme të prokurimit, në prodhimin e regjistrave të operatorëve ekonomik të kontaktuar, në nxjerrjen e procesverbaleve të çmimeve të kuotuar, lëshimin apo dorëzimin me kohë të dosjeve të tenderëve kur parashtrohen kërkesa për to.

Vërehen dobësi në respektimin e afateve kohore të hapjes së tenderëve si dhe mos nënshkrimit të procesverbaleve të hapjes, nga personat përkatës të prokurimit. Janë ekzaminuar disa raste ku komisionet nuk kanë pasur qasjen e nevojshme për vlerësimin e tenderëve bazuar në kriteret e përcaktuara të përzgjedhjes. Janë ekzaminuar disa aktivitete të prokurimit kur publikimet e njoftimeve për dhënien e kontratave janë bërë jashtë afateve të përcaktuara. Është e nevojshme që të merren parasysh udhëzimet dhe rregullat në respektimin e udhëzimeve mbi hapat në caktimin e menaxherëve të projekteve, nxjerrjen dhe nënshkrimin e planeve të menaxhimit të kontratave dhe lëshimit të urdhrave të blerjeve.

Nga 22 rekomandime të lëna nga inspektimi i kaluar, janë përmbushur 15 rekomandime, katër (4) prej tyre janë përmbushur në masë të madhe (përgjithësisht), dy (2) janë përmbushur pjesërisht, kurse një (1) nuk është përmbushur fare.

Në Raportin përfundimtar të inspektimit të kësaj fushe, janë vënë nënëntë (9) rekomandime, të cilat nga drejtuesit e strukturës policore janë pranuar si të bazuara dhe të qëndrueshme. Është arritur pajtim për përmbushjen e këtyre rekomandimeve sipas Planit të Veprimit të përcaktuar.

Inspektimi i menaxhimit të hetimit dhe zbulimit të krimit e administrimit të rasteve

Ky inspektim ka mbuluar aktivitetet, e drejtorive dhe divizioneve qendrore të hetimeve, për periudhën dy (2) vjeçare 2015 dhe 2016. Gjetjet japin një pasqyrë, se struktura aktuale mundëson një ndarje detyrash dhe ndërmarrje veprimesh operative, drejt parandalimit dhe luftimit efikas të krimit. Aktivitetet operative policore mbështeten në një bazë të gjerë ligjesh dhe aktesh nënligjore. Kodi Penal i Kosovës, Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, Kodi i Drejtësisë për të Mitur dhe Ligji për Policinë paraqesin bazën ligjore kryesore që rregullojnë punën hetimore të Policisë. Nuk është arritur ende të stabilizohet struktura e personelit në Departamentin e Hetimit, meqë edhe më tej ka probleme me sistemimin e personelit të graduar dhe plotësimin e vendeve të punës dhe pozitive sipas Listës së Autorizuar.

Departamenti i Hetimit konsiderohet se ka kapacitetet e mjaftueshme profesionale për t'iu kundërvënë nivelit të krimit, meqë personeli hetues është i përgatitur falë programeve bazike dhe të avancuara trajnuese. Lidhur me evidencat e krimit dhe përfshirjes në veprimtari kriminale të individëve dhe grupeve kriminale, ka nevojë për ngritje të bashkëpunimit të trekëndëshit Polici-Prokurori-Gjykatë, në fushën e kthimit të informatave, lidhur me rezultatet e rasteve të iniciuara penale. Një numër dosjesh hetimore nuk kanë pasur raportin policor njoftues për Prokurorinë e Shtetit.



Format e përdorura brenda dosjeve nuk janë unike në kuadër të drejtorive dhe nuk ka një standard të njëjtë të hartimit të shkresave në këto drejtori. Në disa dosje janë gjetur deklarata që nuk i përmbajnë të drejtat e rezervuara të të dyshuarve, gjegjësisht të dëshmitarëve. Në disa prej tyre që i përmbajnë të drejtat e të intervistuarve, ato të drejta nuk janë konform KPPK-së. Ka deklarata të pa nënshkruara nga marrësit e deklaratave dhe personat e dyshuar apo dëshmitarët e intervistuar.

Dosjet hetimore që kanë të bëjnë me persona të arrestuar, kanë qenë të pajisura me aktvendime mbi ndalimin e personit të arrestuar. Lëndët e inspektuara janë të ndara sipas kompetencës lëndore. Kallëzimet penale janë përgatitur kënaqshëm dhe përmbajnë elemente të nevojshme përmbajtësore për t'u dorëzuar në Prokurori.

Raportet policore pasqyrojnë ngritje të aktivitetit hetimor, krahas ngritjes edhe të nivelit të krimit. Indikatorët e performancës pasqyrojnë trend pozitiv të luftimit të krimit. Ka shënuar ngritje numri i kallëzimeve të ushtruara në Prokurori, numri i të arrestuarve, numri i operacioneve, numri i bastisjeve dhe lokaleve të kontrolluara. DHKEK dhe DHTN mbeten drejtoritë me numrin më të madh të rasteve, me të cilat janë ngarkuar në dy vitet e fundit. Nevojitet mobilizim i shtuar në ofrimin e më shumë informatave kthyesë tek DIA, nga drejtoritë hetimore.

Disa nga dosjet që kanë pasur materie e që është lidhur me menaxhimin e vendngjarjes dhe administrimit të dëshmive, vlerësohet se veprimet e ndërmarra nga ekipet e teknikës kriminalistike janë zhvilluar konform dispozitave që parashihen me PSO. Rezultatet e inspektimit lidhur me fushën e ruajtjes, evidentimit e trajtimit të dëshmive janë inkurajuese në shumë pika. Në Dhomën Qendrore të Dëshmive, sendet dhe dëshmitë që janë lidhur me dosjet e përzgjedhura, janë identifikuar lehtë dhe kanë qenë të paketuara dhe të shënuara në mënyrën e duhur.

Lidhur me evidencat vërehet se mbahet Libri i dëshmive dhe evidenca elektronike. Kushtet fizike brenda Dhomës Qendrore konsiderohen të jenë konform standardeve. Dosjet penale ruhen në hapësira të ndara në kuadër të secilës drejtori hetimore. Synohet që ato të mbahen në pronësi të fond-krijuesit deri në dy (2) vite, me kusht që pas kësaj periudhe, kur të konsiderohen të 'përfunduara', të dorëzohen në Arkivin Qendror për ruajtje sipas afateve të ruajtjes. Kushtet në të cilat mbahen dosjet në dhoma të adaptuara, nuk janë të kënaqshme.

Nga inspektimi i kryer ka rezultuar se nga dhjetë (10) rekomandime të lëna në inspektimin e kaluar, gjashtë (6) prej tyre janë përmbushur pjesërisht, tre (3) nuk janë përmbushur fare, ndërsa një (1) rekomandim nuk është vlerësuar në këtë fazë inspektuese. Në Raportin përfundimtar të inspektimit të kësaj fushe janë vënë nënë (9) rekomandime, të cilat nga drejtuesit e strukturës policore janë pranuar si të bazuara dhe të qëndrueshme. Është arritur pajtim për përmbushjen e këtyre rekomandimeve sipas Planit të Veprimit të përcaktuar.

Inspektimi i menaxhimit të ruajtjes dhe kontrollit të kufirit dhe të migracionit

Ky inspektimka mbuluar aktivitetet e Departamentit të Kufirit përgjatë viteve 2015 e 2016. Gjetjet e inspektimit pasqyrojnë se Policia Kufitare ka në dispozicion tërë infrastrukturën e nevojshme ligjore, mbi të cilën bazohet kryerja e detyrave operative. Veprimet që realizohen, synohen të ndërmerren bazuar në praktikat që janë në frymën e standardeve të Schengenit.

Inspektimi vë në pah nevojën e stabilizimit të strukturës me burimet njerëzore siç përcaktohet me Listën e Autorizuar të Personelit. Ka ngecje në përmbushjen e agjendës trajnuese për personelin, duke mbetur prapa plotësimin të kushteve për ri-certifikim dhe trajnime të brendshme. Nevojitet kujdes i shtuar në nominimin e kandidatëve për të qenë pjesë e trajnimeve jashtë vendit. Duhet shqyrtuar politikat mbi freskimin e personelit sipas kriterit të moshës dhe stimulimit të diversitetit gjinor.

Ka ecje para në avancimin e pajisjeve në përdorim nga personeli i stacioneve policore që



lidhen me kontrollin e personave, automjeteve e dokumenteve. Ka një paraqitje të mirë në mbajtjen e evidencave dhe të kujdesit ndaj vulave.

Gjendja e automjeteve konsiderohet jo e kënaqshme, duke ndikuar në rënien e fuqisë aktive të tyre dhe kjo mund të jetë ndikuese në efikasitetin e kontrollit të vijës kufitare.

Policia Kufitare është përfshirë në Menaxhimin e Integruar të Kufirit (MIK) me disa akterë vendorë dhe ndërkombëtarë, andaj bazuar në Planin e Veprimit të Strategjisë për MIK-un për periudhën 2013-2018, bashkëpunimi në mes tyre është i shtrirë brenda autoritetit, në kuadër të MIK-ut dhe atë ndërkombëtar. Takimet e përbashkëta të realizuara me akterët e tre niveleve të bashkëpunimit kanë shënuar rënie. Operacionet e kryera nga njësitë brenda policore kanë shënuar ngritje, kurse ato të përbashkëta me akterët e MIK-ut kanë shënuar rënie.

Me të gjitha vendet fqinje, në përjashtim të Serbisë, janë në fuqi marrëveshjet mbi patrullimet e përbashkëta përgjatë vijës kufitare. Është shënuar shtim i numrit të patrullimeve të përbashkëta me policinë e vendeve fqinje.

Duhet të rishikohen politikat mbi pranim-dorëzimin e detyrave të patrullave kufitare në kuadër të stacioneve të mbikëqyrjes së kufirit, duke marrë parasysh kapacitetet teknike të

tyre. Kontrolli i personave dhe automjeteve ka shënuar ngritje, siç ka shënuar ngritje edhe numri i kontrolleve të vijës së dytë. Ngarkesën më të madhe për stacion/polic vazhdojnë ta kenë Vërmica dhe Hani i Elezit. Sa i përket kontrollit të migrimit, ka shënuar ngritje numri i gjobave të shqiptuara ndaj shkelësve të rregullave mbi lëvizjen e shtetasve të huaj. Ngritje kanë shënuar aktivitetet e Drejtorisë për Migrim dhe të Huajlidhur me inspektimet e bizneseve, institucioneve dhe lokacioneve të dyshimta.

Nëfushën e hetimit të krimit, duhet kushtuar kujdes të shtuar marrjes së gjurmëve të gishtërinjve nga të dyshuarit dhe nxjerrjes së raporteve për Prokurorinë e Shtetit, për rastet kur ka dyshime të arsyeshme se janë kryer vepra penale. Raportet tregojnë se ka rënie të numrit të veprave penale që ndërliken me krimin ndërkufitar. Nga të gjitha rastet e trajtuara, rënie ka shënuar kontrabanda me migrantë, kalimi i paautorizuar i kufirit dhe posedimi i paligjshëm i armëve, kurse kontrabanda me narkotikë, kontrabanda me mallra dhe kontrabanda me kafshë kanë shënuar ngritje. Trend rënës ka edhe numri i arrestimeve për vepra të ndryshme kriminale.

Me gjithë faktin se Sistemi i Menaxhimit Kufitar (SMK) është funksional në të gjitha PKK-të, ai ballafaqohet me disa probleme teknike. Rifreskimi i të dhënave në Stop-Listë paraqet një problematikë, duke i sjellë probleme kontrollit kufitar, për shkak se ato nuk janë të azhurnuara apo të rifreskuara sa duhet.

Sa i përket kushteve të punës në objekte policore, disa prej tyre ballafaqohen me hapësira të pamjaftueshme për punë. Nuk është parë se është krijuar një standard mbi kushtet që duhet të përmbushen nga çdo stacion apo objekt kufitar, duke përcaktuar hapësirat e veçanta për sallat e takimeve, dhomat e intervistave, dhomat e dëshmitëve etj. Disa stacione kryejnë aktivitete në kontejnerë pa hapësira të mjaftueshme pune.

Nuk janë vërejtur dobësi sa i përket mirëmbajtjes së objekteve. Është ecur para me instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në objekte. Duhet bërë ende lëvizje drejt përmirësimit të kushteve, përfshirë vendosjen e hidrantëve, klimatizimit, kontrollimit të pajisjeve kundër zjarrit, alarmit etj.

Nga inspektimi i kryer ka rezultuar se nga 12 rekomandime të lëna në inspektimin e kaluar, tetë (8) prej tyre janë realizuar plotësisht, dy (2) janë përmbushur në masë të madhe (përgjithësisht), një (1) është realizuar pjesërisht dhe një (1) nuk është vlerësuar për shkak se kanë ndryshuar kushtet dhe rrethanat nën të cilat është zhvilluar Policia dhe janë strukturuar togjet patrulluese.

Në Raportin përfundimtar të inspektimit të kësaj fushe janë vënë tetë (8) rekomandime, të cilat nga drejtuesit e strukturës policore janë pranuar si bazuara dhe të qëndrueshme. Është arritur pajtim për përmbushjen e këtyre rekomandimeve sipas Planit të Veprimit të përcaktuar.

Inspektimi i përdorimit të automjeteve policore jashtë orarit zyrtar të punës

Ky inspektim ka mbuluar periudhën e përdorimit të automjeteve nga punonjësit policorë në një datë të rastësishme, 21.11.2017. Inspektimi ka mbuluar inspektimin e automjeteve të shfrytëzuara nga punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë dhe DRP-ve. Gjetjet e inspektimit pasqyrojnë se përdorimi i automjeteve zyrtare policore është i rregulluar me akte nënligjore, me të cilat përcaktohet shfrytëzimi i automjeteve zyrtare. Kjo infrastrukturë ligjore është mirë e kompletuar dhe harmonizuar dhe nuk paraqet pengesë për kryerjen e detyrave policore, por i mundëson autoritetit policor, ushtrim të kontrollit adekuat mbi përdorimin e automjeteve në mënyrë efikase, efektive dhe ekonomike.



IPK-ja është interesuar të verifikojë shfrytëzimin e automjeteve zyrtare jashtë orarit zyrtar të punës dhe në këtë drejtim ka verifikuar diku rreth 100 automjete të përdorura në ditën e inspektimit. Nga verifikimi i tyre është konstatuar se një numër i madh i tyre janë shfrytëzuar mbi bazën e autorizimeve të lëshuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, një pjesë kanë qenë të angazhuara në detyra operationale, por është identifikuar edhe një numër i tyre që, në ditën e inspektimit, nuk kanë arsyetuar përdorimin zyrtar mbi bazën e autorizimeve. Është vërejtur një dukuri e mos vazhimit me kohë të autorizimeve të skaduara nga autoriteti miratues policor.

Nga ky inspektim kanë rrjedhë tre (3) rekomandime, të cilat do të shërbejnë për përmirësimin e performancës, eliminimin e dobësive, por edhe për racionalizimin e përdorimit të automjeteve zyrtare.

Inspektimi mbi kryerjen e detyrave policore në fushën e menaxhimit të ndërtesave policore, infrastrukturës dhe asetëve përcjellëse

Ky inspektim ka mbuluar periudhën dy vjeçare 2015-2016 dhe gjetjet pasqyrojnë se Policia e Kosovës posedon dhe shfrytëzon njënumër të madh të pasurive të paluajtshme (objekte, objekte banimi, poligone të gjuajtjes dhe toka/parcela).



PK posedon regjistër (katalog) me të dhënambi këtë pasuriqë ka në pronësiapo në shfrytëzim, dokument që nuk ka informata të mjaftueshme e gjithëpërfshirëse.

Nuk është hasur në ndonjë dokument që pasqyron sigurimin e objekteve dhe pasurisë në rast të fatkeqësive eventuale. Pajisjet emergjente (hidrantët, aparatet për fikjen e zjarrit dhe sistemi i rrufepritësit) nuk janë testuar brenda afateve kohoretë përcaktuara.

Vërehen mangësi në projektet e përgatitura nga operatorët ekonomikë të kontraktuar, duke vështirësuar realizimin e projekteve në fjalë në fushën e ndërtimit dhe renovimeve. Bazuar në Planin Strategjik Zhvillimor ku parashihet standardizimi i ndërtesave policore, vërehen lëvizje pozitive në përmbushjen e objektivit strategjik.


Nga inspektimi rezultoi se, nga katër(4) rekomandime të lëna nga inspektimi i kaluar, është përmbushurnjë (1) rekomandim dhe tre (3) prej tyre janë përmbushur pjesërisht.

VI. SHËRBIMET FINANCIARE, ADMINISTRATIVE DHE MBËSHTETËSE

Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme (DFSHP) në IPK ka një rol mbështetës dhe shumë të rëndësishëm në menaxhimin e buxhetit, menaxhimin e burimeve njerëzore si dhe menaxhimin e sistemeve të teknologjisë informative dhe shërbimeve logjistike në arritjen e objektivave të Inspektoratit Policor të Kosovës.

Në tabelën dhe diagramin e mëposhtëm, janë prezantuar të dhënat finale buxhetore të IPK-së për vitin fiskal 2017:

Kategoria Ekonomike	Buxheti	Realizimi	Përqindja e realizimit
Pagadhe Mëditje	807,820.07	807,725.01	99.99
Mallra dhe Shërbime	304,075.20	262,583.70	86.35
Shpenzime Komunale	14,800.00	10,697.17	72.28
Totali	1,126,695.27	1,081,005.88	95.94



Në kategorinë ekonomike të projekteve kapitale nuk është realizuar asnjë nga projektet kapitale të parapara për vitin 2017, për arsye se gjatë procesit të rishikimit të buxhetit për vitin fiskal 2017, buxheti i IPK-së ka pasur shkurtime pikërisht në këtë kategori ekonomike.

Aktivitetet e prokurimit kanë përfshirë aktivitetet në pranimin e kërkesave të aprovuara nga njësitë e kërkesës për fillimin e procedurave të reja prokurorese, menaxhimin e procedurave të prokurimit lidhur me aktivitetet e planifikuara. Nga 16 aktivitetet të planifikuara me Planin e prokurimit, janë realizuar 11 prej tyre. Pesë (5) aktivitetet e prokurimit të mbetura janë aktivitetet të cilat Agjencia e Prokurimeve Qendrore (AQP) i ka konsideruar si prokurime qendrore dhe e njëjtaka përcaktuar t'i ndjek procedurat e prokurimit. Gjithashtu, gjatë vitit 2017 janë pranuar dhe përgatitur 165 kërkesa për urdhër blerje për shlyerjen e obligimeve kontraktuale në mes të IPK-së dhe operatorëve ekonomikë.

DFSHP brenda përgjegjësi dhe kompetencave të saj, është përkujdesur në menaxhimin dhe mirëmbajtjen e informatave për burimet njerëzore, ka asistuar menaxhmentin në organizimin e brendshëm, ka ofruar mbështetje administrative, logjistike dhe të shërbimeve të teknologjisë informative, ka siguruar zbatimin e procedurave për përzgjedhjen dhe punësimin e personelit të kualifikuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, ka koordinuar përgatitjen, zbatimin, raportimin dhe vlerësimin e buxhetit, ka koordinuar zbatimin me kohë të detyrimeve financiare të organizatës, ka menaxhuar sistemin e arkivit dhe dokumentet e brendshme, ka ofruar shërbime logjistike, ka mirëmbajtur pajisjet e TI-së dhe ka ofruar shërbime të TI-së.

Nga punonjësit e IPK-së janë ndjekur 14 trajnime, me qëllim të ngritjes profesionale të punonjësve operativ dhe administrativ. Nga tabela shihet llojllojshmëria e trajnimeve të cilat kanë qenë shumë përmbajtësore dhe specifike për punën, detyrat dhe përgjegjësitë që kanë punonjësit operativ dhe administrativ të IPK-së, për të arritur rezultate sa më efektive në zbatimin e mandateve të tyre ligjore.

Tabela: Trajnimet e punonjësve të IPK gjatë vitit 2017

Nr	Llojin e trajnimit	Emri i organizatës	Numrin i pjesëmarrësve
1	Ngasje emergjente	AKSP	1
2	Trajnimi bazik i hetimit të krimit	AKSP	2
3	Komunikimi jo-verbal dhe menaxhimi i stresit	AKSP	3
4	Hetimi i korrupsionit	AKSP	1
5	Sistemi i Integruar i Menaxhimit Emergjent	AKSP	3
6	Krijimi i ekipit dhe zgjidhja e konfliktit	AKSP	1
7	Trajnim bazik i dokumenteve të falsifikuar	AKSP	3
8	Sistemi i Integruar i Menaxhimit Emergjent	AKSP	3
9	Trajnim i avancuar i vëzhgimit	FBI-ICITAP	16
10	Trajnimi për trajner-IKAP-IPK	IKAP	19
11	Shkolla për integrime evropiane	KCSF	1
12	MSA mes Kosovës dhe BE-së	IKAP	1
13	Trajnim për trajner për besueshmërinë dhe kënaqshmërinë në PK	OSBE	2
14	Fuqizimi i kapaciteteve për trajnim të specializuar mbi integritetin policor (trajnim për trajner)	DCAF	5
	Gjithsej		61

VII. MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN, BASHKËPUNIMI VENDOR DHE NDËRKOMBËTAR

Varësisht sipas nevojave operative në terren, në bashkëpunim me departamentet në kuadër të IPK-së, janë publikuar komunikata për media si dhe janë organizuar takime ku janë pasqyruar rezultatet e arritura nga IPK-ja. Aktivitetet e deritashme që janë realizuar gjatë vitit 2017, nga IPK në drejtim të fuqizimit të transparencës dhe bashkëpunimit me qytetarë janë:

- publikimi i rasteve që zgjojnë interesin e opinionit publik (kryesisht përmes komunikatave për media;
- dhënia e deklaratave për mediat, pjesëmarrja në debate televizive, emisione të karakterit informativ etj.;
- angazhime shtesë në fushën e marrëdhënieve me publikun;
- përgatitja, dizajni, redaktimi dhe editimi i revistës “Integriteti”;
- përgjigja në kërkesat për qasje në dokumente publike;
- përgjigja në kërkesat e adresuara nga mediat e ndryshme në çështjet që kanë të bëjnë me aktivitetet e IPK-së etj.

IPK përmes Divizionit për Bashkëpunim dhe Informim në vazhdimësi i ka njoftuar mediat për punën dhe aktivitetet që janë zhvilluar përmes formave të ndryshme me qëllim që të tregoj transparencë dhe informim të duhur qytetarëve dhe atë kryesisht duke trajtuar edhe kërkesat nga mediat e ndryshme. Rol me rëndësi në njoftimin e publikut me punën e IPK-së ka luajtur edhe faqja zyrtare elektronike si dhe përdorimi i rrjeteve sociale si Facebook dhe Twitter.

▪ Aktivitetet për “Linjën e kaltër”



Projekti “Linja e kaltër” është në vazhdimësi, pasi janë vendosur posterët në të gjitha pikë kalimet kufitare në nivel të Republikës së Kosovës si dhe është bërë shpërndarja e broshurave.

Broshurat janë shpërndarë nëpër aktivitete si: “Amerika me Kosovën”, dhe “zhvillimi i aktiviteteve me EVSB-të nëpër Komunitetet e Kosovës” etj.

▪ Publikimi i revistës “Integriteti”



Një ndër angazhimet e IPK-së për vitin 2017, në kuadër të angazhimeve për fuqizimin e transparencës, ishte vazhdimi i publikimit të revistës së IPK-së “Integriteti”.

Përveç informimit të brendshëm, dhe atë kryesisht përmes shkrimeve të ndryshme të botuara në revistën zyrtare të IPK-së, revista “Integriteti” konsiderohet si një projekt i rëndësishëm edhe për informimin e jashtëm e sidomos të zyrtarëve të Policisë së Kosovës, por edhe partnerëve vendorë e ndërkombëtarë për angazhimet e IPK-së si dhe qytetarët e vendit.

Aktivitetet në fushën e marrëdhënieve me publikun

■ Bashkëpunimi me qytetarët

Në fushën e bashkëpunimit me qytetarët, IPK përmes Divizionit për Bashkëpunim dhe Informim (DBI) ka planifikuar koordinimin e fillimit të aktiviteteve për prezantimin e fushëveprimtarisë së IPK-së para qytetarëve të Kosovës. Lidhur me këtë, DBI ka pasur takime paraprake me zyrtarë nga ICITAP, MPB – Departamenti për Siguri Publike -Divizioni për Siguri në Bashkësi, për të prezantuar dhe koordinuar këtë aktivitet.



Përveç këtyre, DBI ka mbajtur dhe organizuar aktivitete (ligjërata) me temën “Inspektorati Policor i Kosovës, roli dhe rëndësia në sundimin e ligjit në Kosovë”, në bashkëpunim me Universitetin “Ukshin Hoti” në Prizren dhe Universitetin “Kadri Zeka” në Gjilan. Pjesëmarrës në këto aktivitete në Prizren dhe Gjilan ishin edhe zyrtarë të EULEX-it, Policisë së Kosovës, MPB-së, ICITAP-it si dhe stafi akademik i dy universiteteve në fjalë, me përkrahjen e të cilëve janë organizuar këto aktivitete.

Gjatë diskutimit të hapur me studentë për fushëveprimin e IPK-së (rolin dhe autorizimet), u dhanë shpjegimet për ecurinë e procedurës hetimore në rastet që trajton IPK në përputhje me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, inspektimet dhe roli i tyre në ngritjen e profesionalizmit të policisë dhe rëndësinë e integritetit policor.

Studentët e universiteteve morën informacione shtesë edhe për rolin e IPK-së në sundimin e ligjit në Kosovë si dhe për projektin e regjionalizimit të IPK-së, respektivisht hapjen e zyrave rajonale në Prizren, Gjiilan dhe Mitrovicën e Veriut.

- **IPK pjesë e projektit “Të rinjtë për Drejtësi”,**

Në kuadër të projektit “Të rinjtë për Drejtësi”, YIHR (Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut) në bashkëpunim me koordinatorët lokal nga “EC ma ndryshe” dhe “Syri i Vizionit” janë mbajtur mbi 20 ligjërata me nxënësit e shkollave të mesme në 10 komuna të Kosovës.



Ligjëratat janë mbajtur në Prishtinë, Fushë Kosovë, Lipjan, Podujevë, Prizren, Suharekë, Dragash, Pejë, Deçan dhe Istog. Në këto ligjërata kanë qenë të pranishëm përfaqësuesit e DBI-së nga Inspektorati Policor i Kosovës, Institucioni i Avokatit të Popullit, Zyrës së Prokurorit Disiplinor dhe Agjencisë Kundër Korrupsionit.

Gjatë këtyre ligjëratave, nxënësit kanë mësuar rreth koncepteve të drejtësisë si qasja, të drejtat dhe llogaridhënia e sistemit të drejtësisë. Gjithashtu, ata janë njoftuar për institucionet e pavarura dhe mbikëqyrëse si dhe rreth punës që ato kryejnë, nga vetë përfaqësuesit e këtyre institucioneve.

- **Bashkëpunimi me MPB-në**



IPK ka trajtuar kërkesat që kanë ardhur nga MPB-ja, sidomos lidhur me raportimet periodike të IPK-së, që kanë të bëjnë me përmbushjen e objektivave strategjike, që dalin si obligim për IPK-në nga plani vjetor i MPB-së, si dhe dokumentet tjera strategjike qeveritare.

- **Bashkëpunimi me Komisionin Parlamentar për Siguri, Punë të Brendshme dhe Mbikëqyrje të FSK-së**

Në kuadër të bashkëpunimit me institucionet vendore, Inspektorati Policor i Kosovës ka pasur një bashkëpunim të mirë edhe me Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës të Kuvendit të Republikës së Kosovës. IPK mirëpret përkrahjen e këtij Komisioni të Kuvendit të Republikës së Kosovës në drejtim të përmbushjes së objektivave strategjike.



- **Bashkëpunimi me Prokurorinë**



Gjatë punës së përditshme, punonjësit e strukturës hetimore dhe menaxhmenti i saj kanë krijuar lidhje bashkëpunimi në drejtim të luftimit të korrupsionit dhe veprave tjera penale në polici. Kjo ka ndikuar që IPK-ja dhe Prokuroria e Shtetit të Republikës së Kosovës, të krijojnë raporte të bashkëpunimit në luftën e dukurive negative të cilat hasen në radhët e pjesëtarëve të PK-së, në veçanti në luftimin e korrupsionit përmes shkëmbimit të informacioneve lidhur me dyshimin e implikimit në veprimtari penale të zyrtarëve policor.

- **Bashkëpunimi me Policinë e Kosovës**

Bashkëpunim me Policinë është orientuar në dhënien e kontributit për ngritjen e performancës së dy agjencive dhe ofrimin e ndihmës reciproke, teknike, operative dhe mbështetëse, të paraparë edhe me legjislacionin në fuqi. Këtij bashkëpunimi i kanë paraprirë disa takime që janë zhvilluar për të diskutuar çështje që ndërlidhen me fushëveprimin e IPK-së.



Përveç takimeve të rregullta, IPK ka pasur edhe disa takime të tjera me zyrtarët e PK-së për marrëdhënie me publikun. Këto takime janë realizuar në frymën e bashkëpunimit dhe komunikimit strategjik kryesisht para publikimeve të raporteve të inspektimit duke diskutuar vijat e përbashkëta të komunikimit me media.

- **Bashkëpunimi me ICITAP-in**

IPK vlerëson lart bashkëpunimin me ICITAP-in Amerikan i cili është i rëndësishë së veçantë dhe ka ndihmuar IPK-në edhe në ndërtimin e kapaciteteve. Trajnimet të cilat ka ofruar ICITAP ndër vite për IPK-në, kanë qenë më se të nevojshme dhe të qëlluara për të arritur përmbushjen e misionit të IPK-së. Ndër trajnimet e rëndësishme të realizuara gjatë 2017-ës ishte "Trajnimi i avancuar për Vëzhgim", për hetuesit e Inspektoratit Policor të Kosovës, i organizuar nga ICITAP-i Amerikan, dhe mbajtur nga instruktorë të FBI-së. Ky trajnim i rëndësishëm është vazhdimësi e mbështetjeve të vazhdueshme drejt ndërtimit dhe fuqizimit të kapaciteteve operative të mekanizmave të sigurisë siç është Inspektorati Policor i Kosovës dhe pason edhe donacionet e shumta të pajisjeve për vëzhgim të realizuara nga ICITAP. Një pjesëtar i IPK-së ka marrë pjesë në seminarin e organizuar nga ICITAP-i që është mbajtur në SHBA (Roswell – NewMexico) së bashku me zyrtarë të tjerë nga PK, Prokuroria dhe Gjykata.



- **Bashkëpunimi me Avokatin e Popullit dhe KMDLNJ**



Gjatë vitit 2017 në kuadër të fuqizimit të bashkëpunimit me mekanizmat që ndërlidhen me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, IPK ka bashkëpunuar me zyrtarët e KMDLNJ-së dhe Avokatit të Popullit duke kthyer përgjigje në të gjitha kërkesat që janë dërguar në adresë të IPK-së.



- **Bashkëpunimi me misionin e OSBE-së**

IPK ka vazhduar bashkëpunimin me misionin e OSBE-së në Kosovë, duke bashkërenduar aktivitetet e përbashkëta që kanë përfshirë trajnimet e organizuara nga ky mision, ku kanë marrë pjesë zyrtarët e IPK-së e deri në bashkë organizimin e punëtorisë, të mbajtur në nëntor, për rishikimin e planit zhvillimor strategjik të IPK-së dhe planit vjetor.



- **Bashkëpunimi me DCAF**



DCAF (*Qendra e Gjenevës për Kontroll Demokratik të Forcave të Armatosura*) në bashkëpunim me Inspektoratin Policor të Kosovës (IPK), Policinë e Kosovës (PK) dhe Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (AKSP) ka mbajtur punëtorinë katër ditore mbi

"Fuqizimin e kapaciteteve për trajnim të specializuar mbi integritetin policor". 16 zyrtarë nga IPK-ja, PK-ja dhe AKSP-ja vijuan këtë punëtori e cila u udhëhoq nga zyrtarët e DCAF-it.

Gjatë kësaj punëtorie u bë prezantimi i *"Manualit të Trajnimit mbi Integritetin Policor"* të DCAF-it për përfaqësuesit e institucioneve të sigurisë dhe u diskutua për implementimin e tij në sistemin e trajnimit policor në Kosovë.

- **Bashkëpunimi me IKAP**

Në kuadër të bashkëpunimit me Institutin Kosovës për Administratë Publike (IKAP), i njëjti certifikoj si trajnerë 21 hetues dhe inspektorë të IPK-së. Ky certifikim erdhi pas një moduli trajnimi intensiv i cili u zhvillua në ambientet e IPK-së nga profesionistë të IKAP-it.



- **Kontakte dhe takime me organizatat simotra nga vendet rajonale**

Gjatë vitit 2017 ka pasur angazhime edhe në drejtim të bashkëpunimit ndërkombëtar që ka përfshirë pjesëmarrjen në grupe punuese ndërkombëtare, konferenca, seminare dhe prezantime të punës së IPK-së në këto takime të karakterit rajonal dhe ndërkombëtar.



Përfaqësues të IPK-së kanë marrë pjesë në takimin e Grupit Punues të EPAC-ut lidhur me përgatitjen e një manuali për “Menaxhimin e riskut dhe analizën e riskut” që është mbajtur më 17 dhe 18 maj në Vjenë të Austrisë në ndërtesën e BAK-ut (Byroja Federale e Anti Korrupsionit – Austri).

Pjesëmarrës në këtë Grup punues kanë qenë edhe përfaqësuesit e agjencive mbikëqyrëse policore respektivisht të mekanizmave antikorrupsion të: Portugalisë, Azerbajxhanit, Hungarisë dhe Austrisë.

Kryeshefi i IPK-së ishte pjesëmarrës në konferencën profesionale të 17-të të EPAC-ut (European Partners Against Corruption – Partnerët Evropian Kundër Korrupsionit), e cila u mbajt në Lisbonë – Portugali 15-17 nëntor 2017.

[Kryeshefi Mehmeti në Konferencën e EPAC-ut](#)



Gjatë zhvillimit të punimeve në konferencë janë trajtuar tema të rëndësishme që kanë të bëjnë me fuqizimin e luftës kundër korrupsionit dhe sundimit të ligjit si dhe bashkëpunimi mes agjencive të ndryshme të zbatimit të ligjit, sidomos të agjencive mbikëqyrëse policore.

IPK ishte pjesëmarrëse në punëtorinë rajonale të organizuar nga RAI (Iniciativa Rajonale Kundër Korrupsionit) dhe Ministria e Punëve të Brendshme të Rumanisë, me përkrahjen e OSBE-së, e cila u mbajt në Bukuresht të Rumanisë me datat 13-14 dhjetor 2017. Në këtë

konferencë morën pjesë përfaqësues të institucioneve të mbikëqyrjes policore dhe agjencive kundër korrupsionit nga shtetet e rajonit dhe më gjerë.

Në këtë punëtori të titulluar “Integriteti dhe standardet profesionale në agjencitë e zbatimit të ligjit” ndër të tjera, nga zyrtarët e shteteve pjesëmarrëse, janë diskutuar çështjet e bashkëpunimit rajonal në këtë fushë, praktikat e aplikuara nga vendet e rajonit dhe më gjerë, identifikimi efektiv i rreziqeve nga korrupsioni, sfidat e përbashkëta etj.

Nga IPK në këtë punëtori ka pasur një prezantim të punës dhe angazhimeve të IPK-së lidhur me integritetin dhe standardet profesionale në agjencitë e zbatimit të ligjit në Kosovë.


- **Angazhimet e tjera**

Përveç aktiviteteve të lartcekura IPK ka qenë e angazhuar gjatë vitit 2017 edhe në përgatitjen e dokumentit lidhur me identifikimin e riskut në IPK, përgatitjen e Planit Vjetor të IPK-së 2018, pjesëmarrëse në shumë aktivitete që ndërlidhen me bashkëpunimin me Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, pjesëmarrës në grupin punues për draftimin e Strategjisë Nationale Kundër Korrupsionit të Agjencisë Kundër Korrupsionit, angazhime për projektin e Këshillit të Evropës dhe detyrat që dalin nga ky projekt, punë në grupe punuese për Procedurat Standarde të Operimit si dhe për Udhëzimin Administrativ për disiplinë si dhe pjesë e grupit punues për draftimin e koncept dokumentit për ligjin për paga, etj.

Gjithashtu, si pjesë e angazhimeve të grupeve të ndryshme punuese, janë përgatitur dhe miratuar edhe këto dokumente për IPK-në: Katalogu i vendeve të punës për strukturën Ooperative, Manuali i burimeve njerëzore, Udhëzuesi për procedurën e planifikimit, inspektimit dhe raportimit, Rregulloren për administrimin e dokumenteve zyrtare, etj.

INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS





Institucioni i Avokatit Popullit në Kosovë
Institucija Ombudsmena na Kosovu
Ombudsman Institution in Kosovo
Kosova Halkin Avukatlar Enstitüsü





INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
POLICIJSKI INSPEKTORAT KOSOVA
POLICE INSPECTORATE OF KOSOVO



**NËSE MENDONI SE U JANË SHKELUR TË DREJTAT TUAJA
NGA ZYRTARËT POLICORË, RAPORTONI NË *LINJËN E KALTËR*:
AKO MISLITE DA SU VAŠA PRAVA PREKRŠENA OD STRANE POLICAJACA
POZOVITE NA *PLAVU LINIJU*:
IF YOU THINK YOUR RIGHTS WERE VIOLATED BY POLICE OFFICIALS,
REPORT IN *BLUE LINE*:**

**RAPORTONI PA PAGESË
IZVESTI BESPLATNO U
FREE OF CHARGE**



080003333

**Së bashku për një polici profesionale
Zajedno za profesionalnu policiju
Together for professional police**

IPK SIGURON KONFIDENCIALITET TË PLOTË NË TRAJTIMIN E INFORMACIONEVE
PIK OSIGURAVA POTPUNU TAJNOST U TRETIRANJU INFORMACIJAMA
PIK OFFERS FULL CONFIDENTIALITY IN TREATING THE INFORMATION